



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 456 / Prot. 5

Tiranë, më 29/5 2017

REKOMANDIM

Nr. 17, datë 29/5 2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Vodafone Albania Sh.a", Tiranë;

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 94, datë 27.03.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Vodafone Albania Sh.a", me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga ana e personit me iniciale K.S. në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale të klientëve debitorë nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit, në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Hetimi pranë këtij kontrolluesi u iniciua mbi bazën e ankesës së paraqitur nga personi me iniciale K.S që pretendonte se kontrolluesi "Vodafone Albania Sh.a" kishte përhapur të dhëna personale pa pëlqimin e tij në adresë të kompanisë "Tranzit Shpk".

Kontrolluesi "Vodafone Albania Sh.a" ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimeve në fushën e telekomunikacionit. Gjatë ofrimit të shërbimeve përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Klientë" (edhe debitorë), manualisht dhe në format elektronik.

I. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "Vodafone Albania Sh.a" ka nënshkruar më datë 11.10.2016 një marrëveshje për shitjen e borxhit me shoqërinë e faktoringut "Tranzit Shpk", në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 9630, datë 30.10.2006 "Për Faktoringun", i ndryshuar. Kjo marrëveshje parashikon ndër të tjera transferimin e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga shitja e borxhit. Sa i përket përpunimit të të dhënave personale parashikon: "Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje dhe njoftimin e rregullt të personave përkatës në lidhje me ekzistencën e saj në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Furnitorit do t'i vihet në dispozicion nga ana e Vodafone tërësia e dokumentacionit dhe të dhënat e Debitorëve përkatës dhe do të veprojë si Kontrollues i të Dhënave në përputhje me parashikimet ligjore.

Mbështetur në këtë marrëveshje, informacioni që i është vënë në dispozicion Tranzitit (marrës i të dhënave) përfshin: a) detaje të identifikimit dhe kontaktit të pajtimitarit (emër, mbiemër, nr. tel. adresë), b) faturë e fundit e lëshuar, c) detyrimi i prapambetur i pajtimitarit, d) kontratën me pajtimitarin.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës, pas analizimit të provave të administruara, u konstatua se përhapja e të dhënave personale të ankuesit me initiale K.S dhe klientëve të tjerë të kontrolluesit "Vodafone Albania Sh.a" në adresë të marrësit "Tranzit Shpk" legjitimohet nëpërmjet rubrikës "Rruajtja e fshehtësisë së komunikimeve telefonike dhe përdorimi i të dhënave personale" të kontratës me pajtimitarin, në të cilën parashikohet mundësia e përhapjes dhe transmetimit të të dhënave personale për qëllime të përmbushjes së kontratës. Kontrata nënshkruhet nga çdo klient duke dhënë në të njëjtën kohë edhe pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale.

Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson se ankesa nuk është e bazuar në prova dhe në fakte pasi çdo klient ka dhënë pëlqimin nëpërmjet nënshkrimit të kontratës, duke vërtetuar edhe marrjen dijeni mbi kushtet e saj.

3. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se kontrolluesi "Vodafone Albania Sh.a" nuk i informon subjektet e të dhënave personale (klientët debitorë), mbi qëllimin dhe mënyrën e përhapjes/transmetimit të të dhënave personale të marrësi "Tranzit Shpk", të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Kriteret ligjore për informimin nuk përmbushen as nëpërmjet formatit të njoftimit të kompanisë "Tranzit Shpk".

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Detyrimi për informim qëndron ndaj kontrolluesit "Vodafone Albania Sh.a" pasi ky i fundit i ka mbledhur të dhënat personale të klientëve për qëllime të ofrimit të shërbimit ndaj tyre dhe nëpërmjet kontratës me "Tranzit Shpk" i përhap të dhënat për një qëllim tjetër (shitja e borxhit). Në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë të dhënat personale në përputhje me qëllimin e grumbullimit (neni 5/1/b) dhe në momentin që qëllimi ndryshon së paku ka detyrimin që të njoftojë subjektin e të dhënave në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave do të konsiderohet i paligjshëm. Detyrimi për informim në rastet e përpunimit/përhapjes/transferimit të të dhënave personale nuk mund të delegohet në asnjë lloj forme dhe duhet trajtuar vetëm në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

4. Në kuadër të zbatimit të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga verifikimi i njoftimit të kontrolluesit "Vodafone Albania Sh.a", paraprakisht rezultoi se nuk ishte përditësuar përmbajtja e tij me ndryshimet që kanë ndodhur në përhapjen dhe transmetimin e të dhënave të klientëve debitorë në kuadër të kontratës së nënshkruar midis kontrolluesit dhe kompanisë "Tranzit Shpk" (në 11 Tetor 2016). Konkretisht rezultoi se nuk ishte përditësuar rubrika 7 "Marrësit e të dhënave personale" dhe nuk ishte plotësuar qëllimi i përhapjes.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet "Formularit të



Njoftimit" është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

Në vijim Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e shpejtë të kontrolluesit për plotësimin e përditësimit të formularit të njoftimit duke pëmbushur detyrimin ligjor përkatës.

5. Në kontratën për shitjen e borxhit, lidhur midis "Vodafone Albania Sh.a" dhe marrësit "Tranzit Shpk", parashikohet se pas vënies në dispozicion të dokumenteve dhe të dhënave të debitorëve "Tranzit Shpk" do të veprojë në cilësinë e kontrolluesit dhe do të mbajë përgjegjësi në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. "Vodafone Albania Sh.a" edhe pse pretendon se nuk është më kontrollues për të dhënat personale të debitorëve që i janë përhapur "Tranzit Shpk", vazhdon përpunon të dhënat personale të tyre nëpërmjet administrimit të kontratave fizike, për të cilat deklaron se janë në proces kalimi.

Zyra e Komisionerit bazuar në parashikimet kontraktore midis palëve vlerëson se statusi "kontrollues" i "Vodafone Albania Sh.a" ndryshon dhe shuhet në momentin e nënshkrimit të kontratës me "Tranzit Shpk". Nga momenti i nënshkrimit të kontratës, për përpunimin e të dhënave të klientëve debitorë (objekt i saj), kontrollues do të konsiderohet "Tranzit Shpk".

Gjithashtu nëpërmjet këtij parashikimi kontraktor specifikohet që pikërisht "Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje" (pra që nga ky moment), "Tranzit Shpk" do t'i vihet në dispozicion nga ana e Vodafone tërësia e dokumentacionit dhe të dhënat e debitorëve përkatës.

Ndërkohë që rezulton që "Vodafone Albania Sh.a" që prej momentit të nënshkrimit të kontratës e në vijim administron dhe përpunon të dhënat e debitorëve në dosjet fizike. Përfaqësuesit e kontrolluesit "Vodafone Albania Sh.a" nëpërmjet komunikimit zyrtar me Zyrën e Komisionerit deklaruan se janë në procesin e kalimit të kontratave fizike të Tranzitit. Kjo nënkupton që "Vodafone Albania Sh.a" vijon të gëzojë statusin e kontrolluesit për debitorët objekt kontrate, në kundërshtim me parashikimin kontraktor.

Zyra e Komisionerit vlerëson se statusi i të qënit ose jo "kontrollues" rrjedh nga rrethanat konkrete të përpunimit të të dhënave personale dhe kriteret e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson gjithashtu se nëse "Vodafone Albania Sh.a" në momentin e nënshkrimit të kontratës ka hequr dorë nga statusi i tij si kontrollues, që nga ky moment nuk legjitimohet që të përpunojë, në asnjë lloj forme, të dhënat personale të klientëve debitorë që tashmë në bazë të kontratës i janë shitur kompanisë "Tranzit Shpk" (e cila fiton statusin e kontrolluesit).

Në këtë kuadër, vijimi i përpunimit manual të të dhënave personale të klientëve debitorë (nëpërmjet administrimit të kontratave fizike) kryhet në kundërshtim me parimin e përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale sanksionuar në nenin 5/1/a të ligjit nr. 9887/2008.

Në përfundim të hetimit administrativ është mbajtur procesverbal i konstatimit dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 22.05.2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e kontrolluesit i qëndruan pretendimeve të paraqitura paraprakisht në formë shkresore dhe elektronike por treguan gatishmërinë për bashkëpunim të mëtijshëm me Zyrën e Komisionerit dhe angazhimin për rikuperimin sa më të shpejtë të shkeljeve të konstatuara.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 22, 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Vodafone Albania Sh.a", në zbatim të nenit 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të përcjellë pranë "Tranzit Shpk" të gjitha kontratat fizike të klientëve debitorë në zbatim të kontratës së nënshkruar midis palëve, në përputhje me qëllimin duke përcaktuar edhe afate kohore konkrete.
2. Kontrolluesi "Vodafone Albania Sh.a", në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave personale (klientët debitorë), mbi qëllimin dhe mënyrën e përhapjes/transmetimit të të dhënave personale të marrësi "Tranzit Shpk", të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë;
3. Kontrolluesi "Vodafone Albania Sh.a", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 45 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 29/5/2017

Besnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI